



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 61014-00715-00-2022 i Regj. Themeltar  
Nr. 00-2022- 1497 i Vendimit (307)**

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ilir PANDA</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Sokol BINAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sandër SIMONI</b>	<b>Anëtar</b>

sot në datë 22.11.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale nr.61014-00715-00-2022, që i përket:

**KËRKUES:** Helidon Gjikota,

**KUNDËR:** Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë,

**OBJEKTI:** Zëvendësimi i masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi"  
caktuar ndaj të pandehurit Helidon Gjikota.

**BAZA LIGJORE:** Neni 260/2 i Kodit të Procedurës Penale.

**KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Sandër Simoni dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN SE:**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga ana e shtetasit Ilir Koka, ka regjistruar procedimin penal nr. 5670 të vitit 2020, për veprat penale "Mashtrimi" me pasoja të rënda dhe "Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve", të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 190/1 të Kodit Penal.

2. Në kuadër të këtij procedimi penal, mbi kërkesën e paraqitur nga organi i prokurorisë, me vendimin nr.1545/ Regj, datë 21.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në burg", ndaj të pandehurit Helidon Gjikota, masë e cila nuk rezultoi të jetë ekzekutuar për shkak se ky i fundit i është shmangur ekzekutimit të saj, duke u vendosur, deklarimi i ikjes sipas nenit 247/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të hetimeve nga ana e prokurorisë është vendosur marrja me cilësinë e të pandehurit e shtetasit Helidon Gjikota, për kryerjen e veprave penale "Mashtrimi" me pasoja

të rënda dhe "Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve", të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 190/1 të Kodit Penal dhe për këtë arsye i është paraqitur kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dërgimin në gjyq të këtij procedimi penal.

**3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë** (gjyqtari i seancës paraprake) me vendimin nr. 1288 Regj, datë 07.05.2021, ka vendosur:

- *Shpalljen e moskompetencës tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për gjykimin çështjes penale nr. 1288,...., me objekt: Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 5670 të vitit 2020 me të pandehur Helidon Gjikota, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 190/1 të Kodit Penal.*

- *Dërgimin e akteve për shqyrtim në gjykatën kompetente, atë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (seancës paraprake).*

**4.** Pas kërkesës së paraqitur nga ana e organit të prokurorisë, Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 105 Regj.Them, datë 12.03.2022, ka vendosur vijimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg" ndaj të pandehurit Helidon Gjikota.

**5. Gjykata e Apelit Vlorë** me vendimin nr. 60-2022-570, datë 24.03.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 105 Regj.Them., datë 12.03.2022 dhe caktimi i masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi" ndaj të pandehuri Helidon Gjikota.

**6.** Në vijim, i pandehuri Helidon Gjikota ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (*gjyqtarit të hetimeve paraprake*), për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arrest në shtëpi" caktuar ndaj tij, me një masë sigurimi më të butë.

**7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**, me vendimin nr. 165, datë 04.05.2022 ka rrëzuar e kërkesës, bazuar në këtë arsyetim: "*....,Gjykata, referuar pretendimeve të kërkuesit dhe mbrojtësit vlerëson se në rastin konkret, nevojat e sigurimit nuk janë zbutur dhe masa e sigurimit "Arrest shtëpie" e caktuar me vendim nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe zbatuar ndaj kërkuesit vazhdon t'i përgjigjet rëndësisë së faktit. Gjendja shëndetësore dhe rrethanat familjare të paraqitura me prova në gjykim nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për zëvendësimin e masës së sigurimit, pasi nuk rezulton që personi nën hetim nuk mund të kurohet në ambientet e shtëpisë apo ti rrezikohet jeta dhe rrethanat familjare nuk janë të tilla që të kërkojnë domosdoshmërinë e zëvendësimit të masës së sigurimit. Gjithashtu rezulton se hetimi nuk është mbyllur dhe kërkuesi vazhdon të jetën hetim për disa vepra për të cilin është vendosur masa e sigurimit. Pra, nuk kemi as lehtësim të akuzës nga organi procedues për kërkuesin".*

**8.** Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim i pandehuri Helidon Gjikota, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr.165, datë 04.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe zëvendësimin e masës së sigurimit "Arrest në shtëpi" me një masë tjetër më të butë, duke prashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqë:

- Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i pambeshtetur në ligj në kushtet kur prokurori është shprehur dakort për pranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit.

- I pandehuri nuk ka rrezik ikje për aq kohë sa ai është vetë vetëdorëzuar në polici dhe ka shfaqur vullnetin për vijimin e hetimit në praninë e tij.

- I pandehuri kërkon ndryshimin e masës së sigurimit "Arrest në shtëpi" me një masë sigurimi më të butë për shkak të rrethanave familjare dhe përgjegjësi thebësore në familje, ushtrimi i të cilave pengohet dhe bëhet i pamundur nga kjo masë sigurimi. I pandehuri jeton me babain e tij, shtetasin Jorgo Gjikota, i moshës 85 vjeç dhe njëri prej shkaqeve që ka diktuar të pandehurin të kthehet nga Britania e Madhe, ka qënë pikërisht kujdesi ndaj babait të tij, i cili jeton vetëm. I pandehuri është i vetmi person që siguron të ardhura për familjen e tij dhe për këtë arsye, masa e sigurimit "Arrest në shtëpi" e pengon atë të punojë, duke e penguar plotësimin e nevojave të familjes.

- I pandehuri ka rrethana specifike shëndetësore (diagnostikuar me Hepatit B kronik), të cilat kërkojnë kujdes të vazhdueshëm dhe vizita periodike mjekësore pranë mjekut specialist.

**9. Gjykata e Apelit Vlorë**, me vendimin nr. 166 datë, 18.05.2022 ka vendosur, ndryshimin e vendimit nr.165, datë 04.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në këtë mënyrë:

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga ana e të pandehurit Helidon Gjikota, me objekt:

- *“Zëvendësimin e masës së sigurimit personal "Arresi në shtëpi", me një masë tjetër më të butë”*. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi" caktuar ndaj të pandehurit Helidon Gjikota me vendimin nr. 570 datë 24.03.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë me masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Garancia pasurore"*, parashikuar nga nenet 234 dhe 236 të K.Pr.Penale.
- Urdhërohet i pandehuri Helidon Gjikota për depozitim pranë një banke të nivelit të dytë, të shumës së garancisë pasurore, në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë të reja, brenda datës 19.05.2022, qëndrimi i të pandehurit Helidon Gjikota nën efektet e masës shtrënguese të "Arrestit në shtëpi" deri në momentin e depozitimit të garancisë pasurore.
- Urdhërohet i pandehuri Helidon Gjikota për njoftimin menjëherë të Prokurorit për depozitim e shumës së garancisë pasurore.
- Ngarkohet Prokurori i çështjes që, menjëherë pas njoftimit të depozitimit, por në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga ky njoftim, të kryejë verifikimin e dokumentacionit përkatës, duke urdhëruar sipas rastit, lirim menjëherëshëm të pandehurit Helidon Gjikota, ose konfirmimin e masës shtrënguese të "Arrestit në shtëpi”.
- Caktimin ndaj të pandehurit Helidon Gjikota të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 14.00.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs sipas ligjit në Gjykatën e Lartë.

10. Gjykata e Apelit Vlorë, në thelb ka bërë këtë arsyetim; *“....Gjykata e Apelit vlerëson se, në rastin e zëvendësimit të masave të sigurimit, ashtu sikundër edhe në rastin e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, do duhet të aplikohet racione materiae ndalesa e parashikuar në pikën 3 të nenit 244 të K.Pr.Penale, në kuptimin që, mendimi dhe vullneti i shfaqur nga ana e Prokurorit në rastin e kërkesës së personit nën hetim apo të pandehurit për zëvendësimin e një mase sigurimi më të rëndë me një masë më të butë, ka rëndësi themelore, në drejtim të ndalimit të gjykatës për rrëzimin e një kërkesë të tillë, për arsye se, gjatë këtij operacioni procedural, është pikërisht Prokurori subjekti procedural, i cili duke ushtruar ndjekjen penale, i njeh në mënyrë më objektive nevojat e sigurimit, duke garantuar një raport proporcional dhe të përshtatshëm midis këtyre të fundit dhe masës që kërkohet të caktohet. Ky konkluzion është rrjedhojë e interpretimit logjik, sistematik dhe teleologjik të neneve 244 dhe vijues të K.Pr.Penale, të cilat sa i përket parashikimit dhe rregullimit të aspekteve procedurale, që lidhen me caktimin, revokimin ose zëvendësimin e masave të sigurimit, synojnë nga njëra anë ushtrimin në përputhje me parimin e ligjshmërisë të së drejtës së prokurorit për të kërkuar kufizimin e lirisë së personit nën hetim apo të pandehurit, në raport me nevojat e sigurimit dhe rëndësinë e faktit, dhe nga ana tjetër, respektimin dhe garantimin e lirisë personale të individit dhe shmangies së kufizimeve arbitrare të kësaj lirie nga ana e organit procedues.*

*Mendimi i prokurorit në rastin e kërkesës për zëvendësimin e një mase sigurimi më të rëndë me një masë më të butë përfaqëson një “condicio sine qua non” për gjykatën që shqyrton kërkesën, në kuptimin që, ajo nuk mund të vendosë refuzimin e saj. Gjykata e Apelit vlerëson se, mendimi i shfaqur nga ana e Prokurorit të çështjes në gjykimin në shkallë të parë, për zëvendësimin e masës e sigurimit “Arrest në shtëpi” caktuar ndaj të pandehurit Helidon Gjikota, me dy masa të tjera sigurimi më të buta, sikundër janë ato të parashikuara nga nenet 234 dhe 236 të K.Pr.Penale, barazohet për nga efektet procedurale me paraqitjen e një kërkesë të re nga ana e Prokurorit. Në këtë kuptim, në vlerësimin e kësaj Gjykate, duke pasur në konsideratë nevojat e sigurimit, rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë shoqërore të pandehurit, si dhe momentin procedural në të cilin ndodhet procedimi penal ndaj tij (për të cilin nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake është vendosur plotësimi i hetimeve, sipas nenit 332/ç të K.Pr.Penale), të dyja masat e sigurimit të cituara si më sipër dhe që përbëjnë edhe objektin e mendimit ose kërkit të prokurorit të shkallës parë, janë proporcionale dhe qëndrojnë në raport të drejtë me nevojat e sigurimit, rëndësinë e faktit dhe rrezikshmërinë shoqërore të pandehurit.*

11. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. 166 datë, 18.05.2022 të Gjykatës Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 165 datë 04.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

- Parashikimet e nenit 244 të K.Pr.Penale, konkretisht paragrafi 3 i tij, në të cilin është parashikuar se: *"Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë nga ajo e kërkuar nga prokurori"*, kanë vlerë vetëm në caktimin e masave të sigurimit dhe këto parashikime nuk mund të shtrihen edhe në kërkesat me objekt *"Zëvendësimi i masave të sigurimit"*, pasi dispozitat përkatëse, neni 260/2 i K.Pr.Penale, ka parashikuar zëvendësimin e masave të sigurimit vetëm kur kanë ndryshuar nevojat e sigurimit dhe në rastin objekt gjykimi këto nevoja të sigurimit nuk kanë ndryshuar.

- Zëvendësimi i masave të sigurimit parashikohet në nenin 260/2 të K.Pr.Penale, në të cilën është parashikuar: *2.Kur nevojat e sigurimit zbuten, ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit, ose dënimit që mund të caktohet, gjykata zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë...*". Nga përmbajtja e dispozitës rezulton se masa e sigurimit zëvendësohet me një masë më të lehtë në këto raste, -kur nevojat e sigurimit zbuten, -kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit, -kur masa e sigurimit e caktuar nuk i përgjigjet dënimit që mund të caktohet. Në rastin objekt gjykimi nuk ndodhemi përballë asnjërit prej rasteve të mësipërme.

- Në kërkimin e të pandehurit nuk ekziston asnjë rrethanë e re, pretendimet e tij për ekzistencën e kushteve të vështira ekonomike e familjare, se personat që ka në ngarkim dhe ai vetë kanë probleme shëndetësore etj, janë vlerësuar më herët nga Gjykata e Apelit, në caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në shtëpi", dhënë me vendimin nr. 60-2022-570, datë 24.03.2022, madje këto rrethana janë vlerësuar nga ajo gjykatë, duke bërë zëvendësimin e masës së sigurimit nga "arrest në burg" me masën e sigurimit "arrest në shtëpi", për të pandehurin Helidon Gjikota.

12. Personi nën hetim ka paraqitur kundër rekurs, duke parashtruar në thelb të njëjtat shkaqe si në apel dhe duke shtuar se:

- Vendimi nr. 166, datë 18.05.2022 i Gjykatës së Apelit Vlorë, është i bazuar në prova dhe në ligj, në kushtet kur prokurori është shprehur dakort për pranimin e kësaj kërkesë. Sipas nenit 244 të K.Pr.Penale, gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të lartë se ajo e kërkuar nga prokurori. Në seancën e datës 04.05.2022 të gjykimit të çështjes nga gjykata e shkallës së parë, prokurori ka deklaruar se nevojat e sigurimit për këtë të pandehur janë zbutur, prandaj sipas tij masa arrest në shtëpi duhet të zëvendësohet me një masë sigurimi më të butë.

- Është prokuroria si organ procedues i hetimit që vlerëson paraprakisht nevojat e sigurimit të përshtatshme për pjesëmarrjen e të pandehurit në procedim dhe shmangien e rrezikut të ikjes ose të ndikimit mbi provat. Qëndrimi i prokurorit për ndryshimin e masës së sigurimit në favor të të pandehurit detyron gjykatën që të zëvendësojë masën e sigurimit me një më të butë, pasi masa e sigurimit e caktuar më parë nuk mbështetet nga prokurori, i cili me kërkimin e tij përcakton kufirin maksimal të masës, që mund të vendoset nga gjykata.

-Në gjendjen që janë aktet, nevojat e sigurimit për procedimin penal nr. 5670/2020 nuk janë të njëjta me ato që kanë ekzistuar në momentin e caktimit të masës së sigurimit për efekt të këtij procedimi, nuk ekziston rreziku i largimit, nuk ekziston rreziku i ndikimit të të pandehurit mbi provat, të cilat janë marrë dhe aktualisht procedimi penal në ngarkim të tij është përfunduar, fakti penal nuk ka të njëjtën shkallë rrezikshmërie shoqërore me faktin penal të vlerësuar në momentin e caktimit të masës së sigurimit, i dyshuari nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore për shkak të personalitetit të tij, gjendjes sociale, sjelljes së tij gjatë procedimit penal.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë**

13.Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se rekursi nga prokuroria

është paraqitur brenda afatit 45 ditor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Personi nën hetim është njoftuar për rekursin dhe ka paraqitur kundërrekurs brenda afatit 20 ditor të parashikuar në nenin 435 të KPP.

14. Në lidhje me masat e sigurimit, e drejta për të ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit është parashikuar shprehimisht në nenin 249, pika 8 të KPP, ku theksohet se "rekursi në Gjykatën e Lartë lejohet për shkelje të ligjit, brenda kompetencës së saj". Në këtë vështrim, rekursi në lëndë të masave të sigurimit duhet të evidentojë shprehimisht shkeljen e ligjit, e lidhur kjo edhe me sa parashikon neni 432 i KPP, ku janë parashikuar shkaqet për të cilat lejohet rekursi.

15. Konkretisht, neni 432 i KPP, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

16. Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP, pasi ngre çështje të zbatimit të ligjit procedural, çfarë përfshihet në juridiksionin ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Si të tilla shkaqet e ngritura në rekurs e bëjnë të cenueshëm vendimin nr.166, datë 18.05.2022 i Gjykatës së Apelit Vlorë. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj personit nën hetim Helidon Gjikota, është rrjedhojë e zbatimit jo të drejtë të ligjit procedural penal dhe konkretisht nenit 260 të KPP, përse i përket vlerësimit të kushteve për zëvendësimin e masës së sigurimit personal.

17. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesat e parashikuara nga neni 260/2 i KPP për revokim ose zëvendësimin e masës së sigurimit, janë në fakt një vlerësim në kohë (*intempore*) i gjykatës pas caktimit të masës së sigurimit ndaj të pandehurit nga gjykata e hetimeve paraprake, në këtë moment të ecurisë së procedimit penal, i ekzistencës së mëpasshme (*ex post*) të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të caktimit masës së sigurimit duke u lidhur ky vlerësim me referimin në nenet 228 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale. Po në analizë të parashikimeve të nenit 260/2 të KPP, i gjithë ky rivlerësim i masës, i iniciuar nga kërkimi i personit nën hetim/të pandehur nëpërmjet mbrojtjes së tij, lidhet me çmuarjen në këtë moment të ndryshimeve, të kushteve dhe kriterëve në raport me vendimmarrjen e mëparshme kur ndaj tij është caktuar masa e sigurimit dhe gjendjen aktuale të provave të këtij procedimi.

18. "Revokimi" dhe "zëvendësimi" i masave të sigurimit janë mjete të verifikimit, ndaj vendimit që cakton masën e sigurimit apo që rrëzon kërkesën për caktimin e saj në ndryshim nga "apeli" dhe "rekursi" të cilët janë mjete të ankimit (pika 3, neni 407 Kodit (Kreu IV Titulli V, Pjesa e Parë e K.Pr.Penale), duke synuar kontrollin e ekzistencës apo jo të kushteve të përgjithshme e të veçanta apo të kriterëve të caktimit të masave të sigurimit. Pikërisht, ky verifikim i kushteve dhe i kriterëve të caktimit të masave të sigurimit, lejon çmuarjen si të atyre fakteve/akteve mbi të cilët është bazuar masa e dhënë, ashtu dhe të atyre të përfituar apo që kanë ndërhyrë/ndikuar, pas caktimit të masës. Në këto kushte, masa e sigurimit mund të rivlerësohet në çdo moment, si përgjatë fazës së hetimeve paraprake, me iniciativë të të hetuarit ose/dhe përgjatë seancës paraprake apo gjykimit të themelit, kur del se, mungojnë kushtet e kriteret e zbatimit të tyre, masa revokohet (pika 1, neni 260 K.Pr.Penale) apo kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, ajo zëvendësohet me një tjetër më të lehtë (pika 2, neni 260 K.Pr.Penale).

19. Sa i përket kërkesës objekt gjykimi, rezulton se gjykatat e faktit janë bazuar në nenin 260 të KPP, në të cilin përcaktohen rastet se kur gjykata mund të zëvendësojë masat e sigurimit dhe në pikën 2 thuhet se: "Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë". Në interpretim dhe zbatim të kësaj dispozite, që përbën dhe bazën ligjore të kërkesës objekt gjykimi, rezulton se ligjvënësi, zëvendësimin e një mase sigurimi, e

ka lidhur me zbutjen e nevojave të sigurimit, ose me mungesën e përshtatshmerisë midis masës së zbatuar dhe rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet. Parë në harmoni me këto kushte, faktet dhe provat e marra në shqyrtim dhe të vlerësuara nga Gjykata e Apelit Vlorë, Kolegji Penal krijon bindjen se të dyja këto kushte nuk janë plotësuar.

20. Kolegji vlerëson se nuk ndodhemi përpara asnjë prej këtyre rrethanave të sipërcituara në nenin 260 të KPP, pasi nuk konstatohet ndonjë ndryshim akuze (*nga momenti fillestar kur ndaj të pandehurit është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg" deri në momentin e paraqitjes së kërkesës objekt shqyrtimi*), e cila mund të parashikojë masë dënimi më të butë dhe masa e re e sigurimit ti përgjigjet rëndësisë së faktit, ose të dënimit që mund të caktohet më vonë. Veprat penale të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 190/1 i Kodit Penal për të cilat i dyshuari është akuzuar që në fillim vazhdojnë të jetë e njëjta dhe aktualisht. Gjithashtu konstatohet se, nga momenti i zëvendësimit të masës së sigurimit "arrest në burg" në "arrest në shtëpi", bërë nga gjykata e apelit me vendimin nr.60-2022-570, datë 24.03.2022, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës (objekt shqyrtimi) për zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi" me një masë më të butë, nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë.

21. Pretendimet lidhur me rrethanat e rënduara/vështira familjare dhe ekonomike të kërkuarit, apo lidhur faktin se i pandehuri është dorëzuar vullnetarisht para organeve të policisë në datën 10.03.2022, për t'ju nënshtuar hetimit dhe gjykimin, janë marrë në konsideratë nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 60-2022-570, datë 24.03.2022, e cila në momentin e verifikimit të kushteve dhe kritereve të masës së sigurimit të "arrestit në burg", të zbatuar ndaj tij, ka zëvendësuar (pro reo) masën e sigurimit me atë të "arrestit të shtëpi". Pra këto rrethana janë konsideruar më parë në vlerësim të kësaj gjykate dhe nuk mund të risjellin ndryshime të tjera të masës së sigurimit ndaj të pandehurit Helidon Gjokoka, duke mos përligjur për të njëjtin shkak kërkesën e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit personal.

22. Lidhur me argumentin e përdorur nga gjykata e apelit, në funksion të justifikimit të ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për zëvendësimin të masës së caktuar të "arrestit në shtëpi", me masat "detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "garancia pasurore", identifikuar në "rrethanën e re", –*mendimi i shfaqur nga ana e Prokurorit të çështjes në gjykimin në shkallë të parë, për zëvendësimin e masës e sigurimit "Arrest në shtëpi" caktuar ndaj të pandehurit Helidon Gjokoka, me dy masa të tjera sigurimi më të buta, sikundër janë ato të parashikuara nga nenet 234 dhe 236 të K.Pr.Penale, barazohet për nga efektet procedurale me paraqitjen e një kërkesë të re nga ana e Prokurorit..., duke nënkuptuar se në një situatë të tillë gjykata duhet të zbatojë parashikimet e nenit 244/3 të KPP.*

23. Kolegji vlerëson se kufizimi i gjykatës sipas nenit 244/3 të KPP, për të mos caktuar masë sigurimi më të rëndë se sa ajo që kërkohet nga prokurori lidhet pikërisht me faktin se është organi i prokurorisë -prokurori i ngarkuar për të kryer hetimet, autoriteti kompetent që në varësi të rrethanave/situatës së çështjes për të cilën kryen hetime, identifikon nevojën e sigurimit të përshtatshme për personin nën hetim. Mbi bazën e kërkesës së argumentuar të prokurorit sipas nenit 244/1 të KPP, gjykata cakton masën e sigurimit, pra gjykata në çdo rast investohet në gjykim kundrejt kërkesës së argumentuar të prokurorit. Edhe në situatën e parashikuar në nenin 260/4 të KPP, ndër të tjera gjykata investohet në gjykim me kërkesë të prokurorit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit, të cilën mund ta paraqesë në çdo kohë kur vlerëson se nevoja e sigurimit ka ndryshuar.

24. Në kuptim të këtyre dispozitave, e drejta dhe detyrimi i prokurorit për t'iu drejtuar gjykatës në secilën situatë sa më sipër duhet të ushtrohet kundrejt paraqitjes së një kërkesë të arsyetuar në gjykatë. Qëllimi i legjislatorit sa i përket zbatimit të dispozitës 260/4 të KPP, nuk është që prokurori të miratojë në gjykim kërkesën që i pandehuri/personi nën hetim paraqet në gjykatë sipas kësaj dispozite, siç ka ndodhur në rastin në shqyrtim, por ti drejtohet me kërkesë gjykatës dhe vetëm në këtë rast, për gjykatën kërkesa e re e organit të akuzës mund të barazohet për nga efektet procedurale me kërkesën e paraqur nga prokurori sipas nenit 244/1 të KPP, ku gjykata nuk mund të caktojë masë më të rëndë se sa ajo e kërkuar.

25. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi nr. 166, datë 18.05.2022 i Gjykatës

së Apelit Vlorë, është rrjedhim i zbatimit të gabuar të dispozitave procedurale penale dhe si i tillë ai duhet të priset dhe të lihet në fuqi vendimi nr. 165, datë 04.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 441/1-b të Kodit Procedurës Penale;

**V E N D O S I:**

Prishjen e vendimit nr.166, datë 18.05.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 165, datë 04.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**Tiranë, më 22.11.2022**